

## **Udhëzues për Aplikantët**

### **Në kuadrin e**

## **Mbulimi i dëmeve në bujqësi dhe ruajtja e kapaciteteve prodhuese**

### **Nën-komponenti 2: Ndhmë financiare Investimi**

Versioni Draft 05 Shtator 2016

---

*Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë*  
*Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie*  
*Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service*

---

## 1. *Objektivat dhe prioritetet e Programit*

### 1.1. *Të përgjithshme*

Në fillim të shkurtit 2015, rreshjet e shumta dhe dëborat e shkrirë mbushën pellgun e lumit Vjosa dhe shkaktuan përmbytje në më shumë se 5,975 hektarë tokë, sidomos në zonat e Vlorës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Gjirokastrës dhe Korçës. Fillimisht, 600 familje u evakuan, tashmë janë kthyer në shtëpi. Nuk u shpall gjendje e jashtëzakonshme.

Ekipi i VNPF-së (Vlerësimi mbi Nevojat Pas Fatkeqësive) pasi shqyrtoi në mënyrë gjithëpërfshirëse situatën vlerësoi në detaje dëmet dhe humbjet në terren. Raporti i VNPF-së vlerësoi humbjet, dëmet dhe nevojat imediate në rreth 110 milionë euro. Arsyet themelore që shpjegojnë shkallën e përmbytjeve nuk kanë të bëjnë thjesht me reshjet e tepërta, apo shkrirja e shpejtë e mbulesës së dëborës për shkak të një temperaturave të nxehta anormale, por lidhet edhe me degradimin e mjedisit, dhe mungesa e ndërhyrjeve dhe menaxhimit të jo të përshtatshëm të pëllgjeve ujëmbledhëse, mungesa e vlerësimit të rrezikut në përdorimin e tokës dhe vendbanimeve, si dhe dobësitë sociale të zonave të prekura.

Bazuar në VNPF-në, BE-ja e konsideron hartimin e një programi të rimëkëmbjes nga përmbytjet që shkon përtej rikthimit hjeshtë në gjendjen e para-përmbytjeve dhe synon rritjen e rezistencës (ulur brishtësinë) në aspektin e infrastrukturës, dhe implikimeve institucionale e sociale. Koncepti themelor është rritja e elasticitetit (aftësisë për tu rimëkëmbur) dhe reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë, përkthyer në mekanizmat paralajmëruese dhe parandalimin e katastrofave qysh në fillim, duke forcuar infrastrukturën për të mundur mbrojtjen nga përmbytjet dhe përgatitjen dhe mbështetjen e sektorëve më të prekur dhe të rrezikuara të bujqësisë

### 1.2. *Objektivat e Programit*

Objektivi kyç i programit është të ndihmojë rimëkëmbjen pas fatkeqësisë të familjeve bujqësore të prekura nga përmbytjet duke adresuar mangësitë kritike të identifikuar përmes VNPF-së, të ndërmarra menjëherë nga autoritetet vendase të Shqipërisë, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe Bankës Botërore.

Objektivi kryesor i aksionit synon rindërtimin e menjëhershëm të jetesës dhe ndërtimin e kapaciteteve të shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për fermerët për të rritur kapacitetet e tyre të përshtatshme ndaj goditjeve që vijnë nga ndryshimet klimatike. Programi në bazët parimeve të veta horizontale zbatohet me qasjen "ndërto më mirë më pas" dhe "ndërto përsëri së bashku" në çdo zonë duke punuar bashkërisht me qeveritë vendore, institucionet publike dhe komunitetet vendore për të hartuar dhe zbatuar aktivitetet e rimëkëmbjes.

Vlera në 14.9 milion euro e Programit "Rimëkëmbja nga Përmbytjet", ndihmë e BE-së, përbëhet nga tre komponentë kryesorë:

- **Komponenti 1- Mbrojtja nga përmbytjet dhe Infrastruktura (6 milion euro):** Qëllimi për rindërtimin e infrastrukturës (argjinaturave, digave, mbrojtjen nga lumenjtë, kanalet ujitës dhe kullues) forcon qëndrueshmërinë ndaj përmbytjeve në zonat e prekura përshtatur me ndryshimet klimatike në të ardhmen.

- **Komponenti 2- Parandalimi i Përmbytjeve/Parapërgatitja dhe administrimi i Fatkeqësive (2,5 milion euro):** Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për Emergjenca Civile Shqiptare, pas veprimeve parandaluese dhe gatishmërisë të krijuhet: harta e rrezikut mbi përmbytjet, sistemi i Paralajmërimit paraprak dhe Integritimit në Sistemin Evropian, ndërgjegjesimi ndaj përmbytjeve (EFAs), Ndërgjegjësim/Dukshmëri/Komunikim, mbështetje për Shqipërinë në përgatitjen për anëtarësim të Bashkimit të Mekanizmave mbi Mbrojtjen Qytetare.
- **Komponenti 3 - Bujqësia dhe Zhvillimi Ekonomik (6,4 milion euro):** dy qëllime kryesore për fermerët dhe agrobizneset, me Grant mbështetje familjeve bujqësore të prekura nga përmbytjet:
  - Grante kesh në vlerën prej 6,1 milionë euro për fermat dhe agrobizneset e prekura, për të mbështetur rimëkëmbjen e jetesës së tyre, ndihmesë në rindërtim më të mirë dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë së tyre/ e afësisë së tyre ripërtëritëse;
  - Rritja e aksesit të fermerëve në teknologjitë e përshtatura nëpërmjet forcimit të shërbimeve këshillimore ndaj nevojave të sektorit të bujqësisë.
- Programi parashikon lëvrimin e dy skemave grante të ndryshme, në kuadër të qëllimit të parë të veçantë sipas Komponentit 3:
  - **Nën-komponenti 1: Grant Shpërblimi** në vlerën 3.4 milionë euro për familjet bujqësore që deklaruan dëmet dhe humbjet dhe të regjistruara në kohën e përmbytjeve;
  - **Nën-komponenti 2: Grant investimi** në vlerën 2,7 milionë euro për familjet e tjera bujqësore dhe agrobizneset, për investime që ndihmojnë në rritjen e qëndrueshmërisë ndaj goditjeve të ardhshme klimatike, duke ofruar praktika të mira bujqësore dhe/ose duke ndikuar drejtëpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik të zonave të prekura nga përmbytjet.

### 1.3. *Objekti i Udhëzuesit për Aplikantët*

Objekt i këtij udhëzimi është Komponenti 3, nënkomponenti 2 i Grantit të investimeve sipas Programit të BE-së “Rimëkëmbja nga përmbytjet” në kuadër të objektivit të parë specifik të Komponentit 3 - Bujqësia dhe Zhvillimi Ekonomik me buxhetin e përgjithshëm paraprak prej 2.7 milion euro.

Granti investimit zbatohet nga MBZHRAU-ja nëpërmjet AZHBR-së (Autoriteti Kontraktues), duke filluar nga thirrja për aplikime deri në pagesën përfundimtare të granteve investuese.

Udhëzuesi për aplikantët dhe anekset e tij përcaktojnë rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen, zbatimin e aktiviteteve të grant investimit dhe pagesën e tyre.

Kopje të këtij Udhëzuesi dhe të gjitha informacionet në lidhje me Thirrjen për Aplikim, mund të shkarkohen në faqen e internetit [ëëë.azhbr.gov.al](http://ëëë.azhbr.gov.al) dhe [ëëë.bujqesia.gov.al](http://ëëë.bujqesia.gov.al)

## 2. *Grant i Investimeve*

Ndihma paraprake e BE-së në Investime arrin deri në 2,7 milionë euro për të gjithë bartësit e projektit, fermerët dhe agrobizneset, duke ofruar projekte investimesh që ndihmojnë në rritjen e

qendrueshmërisë ndaj goditjeve të ardhshme klimatike, duke ofruar praktika më të mira bujqësore dhe/ose përfitime të drejtëpërdrejta të zhvillimit ekonomik të zonave të prekura nga përmbytjet.

Granti për Investime bashkë-financohet (90%) nga BE-ja, (10%) Qeveria Shqiptare dhe zbatohet nga ABZHR-ja si Autoritet Kontraktues, duke nisur nga thirrjet për aplikime deri në pagesën e fundit të grantit të investimeve (BE-ja dhe kontributi kombëtar).

Bashkë-financimi vendas mbi këtë Program (në vlerën prej 710,000 euro) përdoret për nën-komponentin grant-pagesë dhe grant investimi.

Bazuar në listën e përfituesve hartuar për dhënien e ndihmës rregullohet përpjestimi i saktë i grant pagesë/grant investim. Në rast se fondi 3,4 milionë euro për grantin e ndihmës është më i lartë se parashikimi aktual, shuma e mbetur transferohet në financimin e grant investimit. I gjithë buxheti në dispozicion do të disbursohet jo më vonë se shtatori 2017. Granti ofrohet duke ndjekur kriterin/parimin "shërbimi i ofrohet, atij që bën kërkesën i pari". Skema e Grant Investimit zbatohet me anë të thirrjes të hapur deri sa të ofrohen të gjitha fondet e gatshme. 20% e fondeve të gatshme i dedikohen (ndahen) aplikantëve/fermave të vogla, investimi i të cilave është deri në 15 000 Euro ose i barasvlefshëm në Lekë (ALL). Informacioni në lidhje me buxhetin e përvetësuar ABZHR-ja dhe MBZHRAU-ja do ta publikojnë si njoftim në faqet e tyre të internetit, si *Njoftim për ndërprerjen e Thirrjes*. Nuk merren parasysh për Grant dhe nuk shqyrtohen nga ABZHR-ja, aplikimet e dërguara pas datës së njoftimit.

Monitorimi pas shpërndarjes së grantit do të kryhet nga MBZHRAU përmes stafit të AZHBR-së të trajnuar nga projekti SARD.

### **2.1. Objektivat e investimeve**

Pranohen për mbështetje investimet që synojnë objektivat e mëposhtme:

- Rekuperimin e aseteve të dëmtuara nga përmbytjet;
- Përmirësimin e agrobiznesit me investime duke synuar rritjen e kapaciteteve përshtatëse /teknologjike.

Një aplikim mund të synojë njërin ose të dy objektivat.

### **2.2. Përkufizimet kryesore**

*Aplikanti* është fermeri/zotëruesi i fermës në një nga gjashtë zonat e pranueshme, personi fizik ose juridik apo një shoqatë bashkëpunimi që dorëzon aplikimin për grantin e Investimit në thirrjen për aplikime.

*Përfituesi* është person fizik ose juridik apo shoqatë për bashkëpunim të cilit i jepet Grant për investime (projekte).

*Veprime Investuese (Projekti)* është grupi i aktiviteteve të pranueshme për investim në asete fikse të prekshme dhe të paprekshme, duke synuar objektivat e sektorëve që mbështeten dhe për të cilat jepen Grante.

*Shpenzime të pranueshme* janë shpenzimet e miratuara në përputhje me kërkesat e skemës së granteve për Investime për të cilat mund të jepen Grante dhe që janë të listuara në Shtojcën 1 të këtij Udhëzimi.

*Grante* janë pagesat nga Autoriteti Kontraktues (AZHBR) nëpërmjet rimbursimit të një pjese të shpenzimeve të pranueshme të bëra nga përfituesi për investime në asete të prekshme dhe të paprekshme.

*Vendimi për dhënie granti* është vendim i një Autoriteti Kontraktues (AZHBR) për të dhënë grant për aplikantët e suksesshëm në përfundim të procesit të përzgjedhjes.

*Kontributi i BE-së* është shuma e kontributit financiar të dhënë nga BE-ja që është i barabartë me 90% të kontributit të përgjithshëm publik.

*Kontributi Kombëtar* është shuma e kontributit financiar të dhënë nga Qeveria Shqiptare (nëpërmjet AZHBR) i cili është i barabartë me 10% të kontributit të përgjithshëm publik.

*Sipërmarrje* është një entitet ligjor që mund të përbëhet nga një ose më shumë biznese (njësi vendase prodhimi / përpunimi).

*Ndërmarrje* është një njësi (degë) prodhimi vendase, që i përket një sipërmarrje të pranueshme për mbështetje nën këtë skemë të granteve për Investime, me vendndodhje në rajonet e pranueshme (zonat e prekura nga përmblytjet). Në çdo rast, në një thirrje, mund të aplikojnë për mbështetje financiare vetëm një sipërmarrje (degë) e ndërmarrjes.

*Rindërtim* është riorganizim/rinovim i ndërtesës/objektit egzistues.

*Ndërtim* është ndërtimi i një ndërtese/objekti të ri

### **2.3. Intensiteti i ndihmës dhe shuma e mbështetjes (granti), investimi (projekti)**

Intensiteti maksimal i ndihmës së Grantit (e shprehur si përqindje e shpenzimeve totale të pranueshme) **është 90%**, por jo më shumë se **100.000 euro**, për aplikimet në sektorët e **prodhimit primar bujqësor** dhe jo më shumë se **200.000 euro** për aplikimet në sektorin e **agropërpunimit**.

Shuma minimale e investimit është 10 000 Euro dhe nuk aplikohet vlerë maksimale e investimit (projektit). Të gjitha shpenzimet e pranueshme të investimit (projektit) janë më të larta dhe 10% e shpenzimeve sigurohen nga kontributi i (vet) përfituesit.

Nuk janë të pranueshme për mbështetje shpenzimet e përgjithshme të lidhura me shpenzimet e lejuara në zbatim të investimit/ projektit (si ato për arkitektët, inxhinierët dhe tarifat e tjera të konsultimit).

Të gjitha shumat e shprehura në këtë dokument të cituara në euro rillogariten në lekë duke përdorur kursin zyrtar të këmbimit të ditës së parë të punës të muajit kur hapet thirrja, llogaritur dhe publikuar nga Banka e Shqipërisë, (e gjeni në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë: <http://ëëë.bankofalbania.org>).

Granti do të paguhet maksimumi në dy këste. Kësti i parë paguhet, kur më shumë se 50% e investimit (vlerës së grantit) është përfunduar, verifikuar dhe miratuar nga kontrolli në vend (me përjashtim kur pajisjet dhe linjat e përpunimit të ndara nuk mund të jenë funksionale/ operacionale). Përjashtimi nga ky rregull vlen edhe për fermerët e vegjël. Ata do të paguhet vetëm me një këst.

Aplikanti mund të aplikoj me një dosje tjetër për (investime), nëse investimi i mëparshëm ka përfunduar dhe granti është paguar).

#### 2.4. Kërkesat e pranueshmërisë për aplikantët

Aplikantët e përshtatshëm për këtë program janë fermat/pronat bujqësore të cilat:

- kryejnë aktivitete bujqësore (prodhim primar) ose përpunim bujqësor;
- kanë vendndodhjen e tyre të investimit (projektit), në një nga zonat e prekura nga përmbytjet: Fier, Vlorë, Lushnje, Berat, Gjirokastrë apo Korçë;
- ende nuk kanë filluar nga zbatimi i investimit (projektit) të ri
- janë persona me status ligjor (individë fermerë) ose persona fizikë dhe juridikë,

Në mënyrë që të jetë i pranueshëm për një Grant, aplikanti duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të jetë i regjistruar për veprimtarinë në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi
- kanë të drejtë për investime, persona fizikë të prodhimit bujqësor, nëse janë regjistruar me NIPT-in e fermerit. Për investime në prodhimin e agro-përpunimit duhet të kenë të gjitha dokumentet e regjistrimit dhe të licencimit, siç kërkohet nga legjislacionin kombëtar.

Për investimet në prodhimin bujqësor, në sektorët e qumështit dhe mishit, aplikanti duhet **bashkë me kërkesën për pagesë** të plotësojë dhe dorëzojë dokumentet që tregojnë se ai / ajo zotëron:

Sektor	Kërkesat minimale
<b>Për sektorin e qumështit</b>	
për investime në <b>lopë</b>	minimumi 5 lopë të regjistruara në datën e aplikimit në bazë të regjistrimit të kafshëve në MBZHRAU; lopë quhet kafsha femër e lindur në vitin 2015 ose me moshë më të madhe në momentin e thirrjes së parë për aplikim
për investime në <b>dele/dhi</b>	minimumi 50 dele dhe / ose dhi, në datën e aplikimit, të të gjitha moshave dhe sekseve të regjistruara në regjistrin e kafshëve në MBZHRAU
<b>Sektori i Mishit</b>	
për investime në <b>sektorin e rritjes së viçave për mish</b>	5 gjedhë të regjistruar të të gjitha moshave në regjistrin e kafshëve MBZHRAU në datën e aplikimit
për investime në <b>sektorin e mishit të deleve/ dhive</b>	50 dele dhe/ose dhi, regjistruar në regjistrin e kafshëve MBZHRAU në datën e aplikimit
për investime në <b>sektorin e mishit</b>	5 Krerë dosa në mbarëshitim

Sektor	Kërkesat minimale
<b>të dërrit</b>	
Për investime në sektorin e mishit të pulave (zogjve)	1,000 krerë shpendë (zogj për mish)

- **Për prodhimin bujqësor, sektorin e frutave dhe perimeve;** aplikanti duhet të plotësojë dhe të paraqesë në dosjen e aplikimit dokumentet që vërtetojnë se ai / ajo zotëron një minimum të nevojshëm sipërfaqe toke, dhe në momentin e kërkesës për pagesë sipërfaqja minimale e tokës që duhet të jetë e kultivuar si më poshtë:

Sektori i frutave dhe perimeve:	
“Në fushë të hapur”	- aplikanti <b>zotëron në datën e aplikimit</b> minimumi një sipërfaqe prej 1 ha që mund të kultivohet dhe në fund të investimit ( <b>para pagesës së grantit</b> )- janë kultivuar <b>minimumi 0.5 ha</b> tokë me perime apo me fruta në një ose disa blloqe me mundësi rotacioni/ qarkullimi.
“fruta dhe perime në ambiente të mbrojtura”	aplikanti <b>zotëron në datën e aplikimit</b> minimumi një sipërfaqe prej 0.4 ha që mund të kultivohet, dhe në fund të investimit ( <b>para pagesës së grantit</b> ) - minimumi 0.2 ha zonë e mbrojtur në formën e serave me xham / serave plastike/ ose tuneleve me një lartësi minimale prej 2.8 metra.

- të jenë pronarë toke në Shqipëri, ose të kenë marrë tokë me qira (në bazë të legjislacionit kombëtar në fuqi) në Shqipëri për aktivitete të pranueshme të investimit (projektit) për minimumi 10 vjet që nga paraqitja e aplikimit;
- të mos kenë detyrime të papaguara ndaj shtetit, siç kërkohet nga ligji kombëtar, sipas statusit ligjor të aplikuesit, me vetëdeklarim
- të mos kenë detyrime financiare në lidhje me aktivitetin ekonomik (në lidhje me taksat (përfshirë taksat e tokës ose tatimit mbi pronën - ndërtesën ku zhvillohet aktiviteti ekonomik) detyrime ndaj sigurimeve (shëndetësore dhe shoqërore/pension);
- të mos kenë detyrime ndaj MBZHRAU;
- nuk duhet të jetë në listën kredive të këqija të AZHBR-së;
- Investimi quhet ekonomikisht i realizueshëm dhe i pranueshëm, kur vlera aktuale neto është e barabartë ose më e madhe se zero dhe norma e brendshme e kthimit e barabartë ose më e madhe se zero.

Në përfundim investimi (para pagesës përfundimtare) duhet të përmbush standardet minimale kombëtare në fuqi.

Përputhshmërinë me kërkesat për kualifikim në këtë Udhëzim dhe thirrje për aplikim, aplikantët duhet t'i mbështesin me dokumentet e listuara në Listën e dokumenteve e cila është pjesë e formularit të Aplikimit (Aneksi 3 i këtij Udhëzimi), duke ndjekur shënimet e udhëzimit.

Aplikantët (me nënshkrimin e formularit të aplikimit dhe kontratës për dhënien e grantit) duhet të deklarojnë dhe të konfirmojnë në formën e Aplikimit (Aneksi 3 i këtij Udhëzimi) deklaratat në vijim, në të kundërt aplikimi do të refuzohet (kur):

- investimi (projekti) nuk parashikohet të realizohet në rajonet Fier, Vlorë, Lushnje, Berat, Gjirokastër dhe Korçë;
- investimi (projekti) për të cilin është dorëzuar aplikimi në AZHBR ka filluar para datës së nënshkrimit të kontratës me AZHBR;
- informacionet e dhëna në kërkesë nuk janë të vërteta dhe të plota dhe u ka skaduar afati i vlefshmërisë si dokumente mbështetëse;
- aplikanti / përfaqësuesi ligjor që ka përgatitur, menaxhon dhe zbaton investimin (projektin) ka dhënë deklaratat të rreme, jo të plota apo çorientuese
- investimi për të cilin aplikohet është financuar nga një program tjetër kombëtar apo i BE-së
- aplikanti, përfaqësuesi ligjor i aplikantit (kur aplikohet) dhe aksionerëve me aplikantin (kur aplikohet) janë në konflikt interesi me furnizuesit nga të cilët kanë marrë ofertat
- aplikanti, përfaqësuesi ligjor/i aplikantit (nëse aplikon) dhe partnerë të aplikantit (nëse aplikojnë) nuk kanë konflikt interesi, në bazë të Ligjit nr. 9367 e datës 7. 4. 2005 "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike" i ndryshuar;
- Nëse jepet Granti, aplikanti/përfituesi ofron qasje në objektet, dokumentet dhe çdo informacion që i kërkohet për çdo kontroll që kryhet sipas rregullave të skemës së grantit të Investimeve dhe pranon të mbështesë këto shërbime kontrolli;
- Për qëllime të mbrojtjes së interesave financiare të BE-së, aplikanti pranon që të dhënat e tij personale kalojnë në shërbim auditimi të brendshëm, të Gjykatës Evropiane të Auditorëve, të Panelit të parregullive financiare apo Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit;
- Aplikanti që merr Grant pranon kushtet kontraktuale të përcaktuara në projekt-kontratën e Grantit sipas modelit në dispozicion në faqen e internetit të AZHBR [ëëë.azhbr.gov.al](http://ëëë.azhbr.gov.al)
- nëse granti i jepet, aplikanti/përfituesi pranon që emri i tij dhe të dhënat mbi Grantin, publikohen në faqen e internetit të AZHBR [ëëë.azhbr.gov.al](http://ëëë.azhbr.gov.al).

## 2.5. Sektorët dhe investimet e pranueshme

---

***Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë  
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie  
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service***

---



Sipas kësaj skeme grant Investimesh janë të pranueshme sektorët në vijim:

**Sektorët e prodhimit primar në:**

- kulturat në fushë të hapur (frutat, duke përjashtuar kopshtet, por duke përfshirë luleshtrydhen, perimet, bimët foragjere dhe drithërat)
- serrat/ tunelet me lartësi minimumi 2.8 metër (për prodhimin e perimeve/frutave, përfshirë luleshtrydhen)
- pemëtoret dhe vreshtat
- blegtori (shpend, të imëta, bletë, gjedhë dhe derra)
- bimë aromatike dhe mjekësore

A. **sektorët e përpunimit:**

- qumësht dhe përpunimi i tij
- përpunimi i mishit
- përpunimi i frutave dhe/ose perimeve (përfshirë bimët aromatike dhe mjekësore)
- prodhimi i mjaltit
- prodhimi i verës dhe vajit

Aplikimi përfshin investime vetëm në një sektor. Refuzohen aplikime që parashikojnë investime në më shumë se një sektor të pranueshëm ose të papranueshëm.

Llojet e pranueshme të investimeve sipas kësaj skeme grant Investimesh janë si më poshtë:

- ndërtimi i ndërtesave/objekteve të reja dhe/ose rindërtimi i ndërtesave/objekteve egzistuese;
- blerja e pajisjeve, aparatuarave dhe makinerive të reja;

Kërkesa për pagesë për të gjitha investimet e fituara bëhet jo më vonë se fundi i shtatorit 2017.

Data e fundit për dorëzimin e kërkesës për pagesë specifikohet në Grant kontratën individuale midis Autoritetit Kontraktues (AZHBR-së) dhe përfituesit përfundimtar. Kërkesa refuzohet nëse zbatimi i investimit/projektit të planifikuar tejkalon afatin.

## ***2.6. Shpenzimet e pranueshme***

Shpenzimet e pranueshme të investimit (projektit) listohen në Aneksin 1 të këtij Udhëzuesi sipas skemës së grant Investimit. Për llogaritjen e grantit merren parasysh vetëm shpenzimet e pranueshme.

Shpenzimet e pranueshme duhet të bazohen në shpenzime reale dhe dorëzohen me dokumentat mbështetëse (ofertat dhe/ose faturat) të cilat ruhen më tej.

Gjatë shqyrtimit të çdo aplikimi (para nënshkrimit të Grant Kontratës me aplikantin e kualifikuar për investime të pranueshme) Autoriteti Kontraktues (AZHBR-ja) kontrollon buxhetin e zbatuar të investimeve. Në rast se, identifikohen probleme që kërkojnë ndryshime në buxhetin e investimeve (si gabime aritmetike, pasaktësi apo shpenzime joreale dhe shpenzime të tjera të papranueshme), Autoriteti Kontraktues (AZHBR-ja) kërkon shpjegime dhe/ose detyron ndryshime dhe/apo zbritje. Është në interes të aplikantit të ofrojë buxhet real dhe me shpenzime investimesh efektive, pasi vlera e Grant-it dhe/apo intensiteti i ndihmës nuk rritet për këtë arsye.

Shpenzimet e pranueshme janë shpenzime e bëra në fakt nga përfituesi dhe të cilat janë:

- Të përfshira në Listën e Shpenzimeve të pranueshme (Shtojca 1 i këtij Udhëzimi);
- të nevojshme për kryerjen e investimit (projektit) (përfshirë shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes);
- të identifikueshme dhe të verifikueshme;
- të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e mirë-administrimit financiar, në veçanti me efektivitetin ekonomik;
- shpenzime në lidhje me blerjen e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshirë programe kompjuterike deri në vlerën e çmimit në treg;
- shpenzime në lidhje me ndërtimin dhe/ose rindërtimin, si përmirësim i pasurisë së paluajtshme;
- shpenzime të kryera dhe disbursuara pas kontratës së Grantit të fituar nëpërmjet AZHBR (pas datës së nënshkrimit të kontratës me AZHBR);
- shpenzime të përfshira në buxhetin e investimit (projektit) në kontratën e Grantit;

Çdo pagesë në lidhje me blerje makinerie dhe punë ndërtimi dokumentohet nga përfituesi nëpërmjet faturave të lëshuara nga furnizues të regjistruar ose ofrues shërbimesh.

Për të gjitha zërat e shpenzimeve të investimit (projektit) duhet të mblidhen ofertat dhe zbatohen rregullat e mëposhtme:

- janë të domozdoshme tri oferta të krahasueshme nga ofertues të pavarur për çdo shpenzim të pranueshëm të investimit (projekt) të zbatuar. Një ofertë mund të përmbajë kuotime/ vlera për më shumë se një zë shpenzimesh duke përfshirë edhe shërbimet (e palëve të treta);
- Aplikanti zgjedh ofertën më të lirë (në të kundërt paraqisni shpjegime se përse është zgjedhur oferta më e shtrenjtë); në sejcilin rast që AZHBR-ja pranon ofertën më të shtrenjtë, paguan jo më shumë se vlera e ofertës më të lirë.
- Furnizuesit/ofertuesit nuk duhet të jetë në konflikt interesi me një njëri-tjetrin ose me aplikuesit (si dhe në aspektin e pronësisë);
- Llogaritja e shumave nga monedhë e huaj në lekë për ofertat nga ofertues/it e huaj kryhet me kursin e këmbimit të ditës së parë të punës të muajit në të cilin hapet thirrja. Kursin e këmbimit e

gjëni në adresën e mëposhtme të internetit të Bankës së Shqipërisë <http://ëëë.bankofalbania.org>).

Çdo ofertë duhet të përmbajë elementet dhe informacionet e mëposhtme:

- Numrin e referencës dhe datën e lëshimit;
- emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit të ofertuesit;
- deklaratën mbi origjinën e mallrave/shërbimeve/punimeve të ofruara;
- Modeli dhe më e rëndësishmja, specifikime teknike, në rastin e pajisjeve apo mekanizimit;
- Faturat e sasisë në rast punimesh;
- Çmimi pa TVSH, TVSH-ja e cituar më vete, taksa të tjera të shprehura më vete; Çmimi i përgjithshëm i ofertës;
- Vlefshmëria e ofertës;
- Nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor dhe vula zyrtare e ofertuesit/ furnizuesit;
- çdo ofertë përfshin kopje të çertifikatës së regjistrimit të ofertuesit/ furnizuesit;
- deklaratë nga ofertuesi që të gjitha pajisjet/makineritë në ofertë janë të reja dhe të pa përdorura.

## 2.7. Shpenzime të papranueshme

Nuk pranohen të merren parasysh për llogaritjen e Grantit, shpenzimet e mëposhtme:

- Punime rutinë të mirëmbajtjes së ndërtesave dhe objekteve (mirëmbajtje rutinë nënkupton shërbime që kryen rregullisht dhe që kanë për qëllim për të zgjatur jetën e dobishme, të domosdoshme në sistemin e ndërtimit dhe zvogëlojnë nevojën për riparime të mëdha);
- Punimet e aplikantit apo të afërmit/ve të tij, punëtorëve të ndërmarrjes nuk janë pjesë e kostove të pranueshme (punimet e ndërtimit duhet të kryhet nga një palë e tretë e regjistruar dhe kontraktuar);
- Blerja e pajisjeve dhe makinerive të dorës së dytë (të përdorura);
- blerja, qeraja ose dhënia e tokës dhe ndërtesave aktuale, të drejtat e prodhimit bujqësor me qera;
- shpenzimet e bëra nga aplikanti, para fitimit të Grantit nga AZHBR, dmth përpara datës së nënshkrimit të kontratës me AZHBR-në;
- shpenzime të përgjithshme, aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e aplikimit dhe kërkesë pagesave për zbatimin e investimit (projektit), të tilla si përgatitja e përshkrimeve të Investimit, projekteve teknike, etj .
- shpenzime/ kostot operative (të konsumit, shërbime dhe furnizime karburanti - energji elektrike, ujë, naftë, gaz, etj), mirëmbajtje, amortizim dhe shpenzime qiraje;

- kontribute në natyrë;
- TVSH-ja dhe taksa të tjera;
- shpenzime doganore dhe detyrime importi apo çdo detyrim tjetër;
- gjoba, ndëshkime financiare dhe shpenzime procesi gjyqësor
- tarifa bankare, shpenzime garancie dhe detyrime të ngjashme;
- shpenzime për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi, si edhe shpenzime të tjera financiare;
- qera-blerje, diferencë qeradhënie, shpenzime për rifinancim të interesit, shpenzime të përgjithshme dhe tarifa sigurimi;
- borxhe dhe shërbime borxhi, detyrime për humbje apo detyrime të mundshme në të ardhmen;
- Pagesat e interesave të borxhit;
- Shpenzimet e deklaruara nga Përfituesi i Grantit por të përfshira në një investim tjetër të financuar nga një program tjetër kombëtar ose donator.
- çdo shpenzim i kryer nga administrata publike gjatë menaxhimit dhe zbatimit të asistencës

### **2.8. Kërkesa të pranueshme për investime**

Aplikimet mund të përfshijnë vetëm investime në **asete të luajtshme dhe të paluajtshme**.

Skema e grantit mbështet vetëm investime që do të zbatohen pas **nënshkrimit të Kontratës së Grantit** me AZHBR, dmth. pas datës së nënshkrimit të kontratës me AZHBR-në.

Investimi duhet të jetë i lidhur me prodhimin apo përpunimin e produkteve bujqësore në sektorët e pranueshëm dhe produkti përfundimtar duhet të jetë i përfshirë në Aneksin I të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (Aneksi 2 i këtij Udhëzuesi).

Investimi pas përfundimit (para pagesës përfundimtare) duhet të plotësojë standardet përkatëse kombëtare minimale në fuqi.

Investimet si pajisjet/ makineritë/ apo teknologjitë të cilat mbulohen nga Direktivat për Stampën CE duhet gjithashtu të përmbushin edhe standardet e KE-së, provuar nga stampa CE, në fund të realizimit të investimit.

Pajisjet dhe makineritë **duhet të kenë origjinën nga Shqipëria, shtetet anëtare të BE-së ose vende të tjerë të pranueshëm sipas rregullores së IPA-s.**

Lista e vendeve të pranueshme të origjinës jepet në Aneksin 7 të këtij Udhëzuesi.

Me rastin e investimeve në energjinë e rinovueshme shpenzimet e pranueshme janë të lidhura vetëm për vetë-konsum të bujqësisë dhe / ose aktivitetit agro-përpunues.

Në rast të ndërtimit dhe / ose rindërtimit, duhet të përgatitet dokumentacioni teknik me planet e ndërtimit / rindërtimit përfshirë dokumentet e tjera përkatëse siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar dhe të paraqiten me aplikimin sikurse janë planet arkitektonike dhe inxhinierike, instruksionet, etj të cilat duhet të bëhen nëse kërkohet nga legjislacioni kombëtar. Leja e përdorimit, siç kërkohet nga ligji kombëtar, duhet të dorëzohet para kontraktimit.

**Nëse ndërtesa, lokalet apo trualli përreth ose toka nuk janë në pronësi të aplikantit**, aplikanti domosdoshmërisht **duhet** të ketë një kontratë qiraje për minimalisht 10 vite nga data e aplikimit

Nëse ndonjë nga kërkesat e përmendura më sipër mbi pranueshmërinë e aplikantit apo investimeve apo shpenzimeve nuk përmbush kriteret dhe nuk ka mundësi për ridorëzim dokumentacioni, atëherë AZHBR-ja njofton për mos pranimin e aplikimit. Në raste të tjera, që nuk janë të përcaktuara qartë më sipër, AZHBR-ja merr vendim rast pas rasti, duke siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve (dhe aplikimeve) në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe ky vendim miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Aplikantit do t'i jepen afat 10 ditë kalendarike të ridorëzojë dokumentacionin e munguar, dhe nëse dokumentet nuk dorëzohen brenda afatit apo nuk janë të plota, aplikimi nuk pranohet.

### 3. Procedura e Aplikimit

#### 3.1. Përmbajtja e Aplikimit

Aplikantët dorëzojnë Formularin e Aplikimit (Aneksi 3 i këtij Udhëzuesi) dhe dokumentet mbështetëse, të listuara në Listën e dokumenteve, pjesë përbërëse e formularit të Aplikimit, duke ndjekur udhëzimet. Të gjitha këto dokumente sëbashku formojnë "dosjen e aplikimit". Aplikimi duhet të dorëzohet në gjuhën Shqipe. Dokumentet e aplikimit nuk duhet të plotësohen me shkrim dore. **Aplikimet e plotësuara me me shkrim dore nuk do të pranohen.** (nuk janë në variantin anglisht)???

Dokumentet mbështetëse dorëzohen për t'i lejuar autoritetit kontraktues (AZHBR) verifikimin e pranueshmërisë së aplikantit, investimeve dhe shpenzimeve. Dokumentet mbështetëse të kërkuara dorëzohen në formën origjinale, ose fotokopje të verifikuara nga noteri, siç tregohet për çdo dokument në instruksionet (Aneksi 3 i këtij Udhëzuesi). Nëse dokumentet mbështetëse nuk dorëzohen në gjuhën shqipe, bashkëngjisni përkthimin zyrtar në gjuhën shqipe.

Aplikantët duhet të përdorin llojet e modelit/ template-it, të parashikuara në grantin e Investimeve (Aneksi 3-5 i këtij Udhëzuesi).

Aplikanti dorëzon dosjen e aplikimit në formë shkresore (shoqëruar me të gjitha dokumentet e aplikueshme dhe të përshkuara mbështetëse).

Çdo gabim apo mospërputhje e rëndësishme në lidhje me pikat e renditura në instruksionet në formularin e aplikimit apo ndonjë mospërputhje e rëndësishme në formularin e aplikimit sjell mos pranimin e aplikimit. Kërkohen shpjegime vetëm kur informacioni i dhënë është i paqartë dhe si i tillë pengon që autoriteti kontraktues (AZHBR-ja) të kryej vlerësim objektiv.

### 3.2. Thirrja për Aplikime dhe dorëzimin e Aplikimeve

AZHBR-ja dhe MBZHRAU hap Thirrjen për Aplikime. Thirrjet për aplikime, bashkë me financimin, i gjeni në faqen e internetit të AZHBR-së [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al). Kjo thirrje njofton aplikantët për datën e fillimit të dorëzimit të dosjeve të aplikimit. Meqenëse kjo skemë grant Investimi realizohet përmes thirrjes së hapur, deri në momentin kur të gjitha fondet në dispozicion të jenë kontraktuar, AZHBR, për informimin e publikut në lidhje me buxhetin e absorbuar do të përgatisë dhe publikojë në faqen e internetit *Njoftimin për ndërprerjen e Thirrjes*. Gjithashtu, Njoftimi do të publikohet edhe në faqen e internetit të MBZHRAU-së. Aplikimet e dërguara në AZHBR pas datës së njoftimit nuk merren parasysh për Grantin dhe nuk shqyrtohen nga AZHBR-ja.

Aplikimet dorëzohen në zarf të mbyllur me emrin dhe adresën e plotë të aplikantit dhe shënimin e mëposhtëm:

**Thirrje për aplikim**  
**Rikuperimi i dëmit në bujqësi dhe rikthimi i aftësisë prodhuese**  
**“Të mos hapet përpara dorëzimit”.**

Aplikimet duhet të dorëzohen **ose**:

- Nëpërmjet dërgesës postare rekomande, shërbimi i lajmërim-marrje; **ose**
- Dorazi (duke përfshirë shërbimet korriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga:

**Agjencia e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor**  
**Rruga Muhamet Gjollesha Nr. 56**  
**1001 Tiranë, Shqipëri**

Data e pranimit është data e dorëzimit të aplikimit në AZHBR. AZHBR-ja kujdeset mbi pronësinë e të gjithë aplikimit të marrë. Rrjedhimisht, përfituesit nuk mbajnë kopje origjinale të aplikimit të tyre (përveç faturës/ave origjinale).

Aplikanti mban kopje të aplikimit të paraqitur, përfshirë të gjitha dokumentet origjinale, nëse në AZHBR dorëzon kopje të verifikueshme noteriale (kështu, dorëzimi i kopjeve të noterizuara, është lehtësisht i kontrollueshëm dhe i krahasueshëm me origjinalet gjatë kontrollit në vend). Në rast mospërputhjeje, aplikimi nuk pranohet ose refuzohet dhënia e pagesës. Dokumentet origjinale duhet të përmbajnë të gjitha elementet siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi (si psh: vula, nënshkrimi, apo nr. i protokollit).

### 3.3. Pranimi dhe regjistrimi i aplikimeve

Pasi pranohet dosja e aplikimit, AZHBR-ja gjeneron numër protokollit, sipas procedurave standarte, dhe numrin e ID-së së Aplikimit për çdo dosje aplikimi.

### 3.4. Përzgjedhja dhe lidhja e kontratës

Të gjitha aplikimet e dorëzuara vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme:

---

***Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë***  
***Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie***  
***Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service***

A. **Kontrolli për plotësinë dhe pranueshmërinë e aplikimeve:** përputhja administrative dhe e drejta e aplikantit, investimeve dhe shpenzime të pranueshme në bazë të dokumenteve mbështetëse të paraqitura. Nëse mungon ndonjë nga dokumentet e kërkuara mbështetëse ose është i pakompletuar, apo është administrativisht i papranueshëm, përfituesi thirret të ridorëzojë dokumentin/(at) me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike. Nëse dokumenti/at nuk paraqiten brenda këtij afati, aplikimi nuk pranohet. Gjithashtu, në qoftë se nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikanti ose investimi nuk plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për aplikim, atëherë aplikimi do të refuzohet. Pjesë e këtij kontrolli është vlerësimi i "përshkrimit të Investimit" (Aneksi 4 i këtij Udhëzuesi) dhe oferta/t e paraqitura.

Kërkesa do të refuzohet pa kërkuar dorëzim / ri-dorëzim të dokumenteve, në rast të **mangësive të mëdha** në plotësimin e kërkesave të mëposhtme:

- Kur Aplikimi është dorëzuar pas përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimeve;
- Mungesa e Formularit të Aplikimit;
- Pjesës përshkruese ose financiare të Projektit Teknik të propozuar;
- Mospërdorimi i modelit standart të Formularit të Aplikimit dhe Formularit të Përshkrimit të Investimit
- Formulari i Aplikimit është plotësuar me shkrim dore;
- Mungesa e dokumentave mbështetëse bashkëlidhur me formularin e aplikimit;
- Mungesa e të paktën tre ofertave orgjinale, të krahasueshme në përputhje me të gjitha kriteret e kërkuara në lidhje me ofertat;
- Të paktën një prej ofertave është në konflikt interesi, siç përshkruhet më sipër;
- Mungesa e projektit (konstruktiv dhe arkitektonik)në rastin e aplikimeve për ndërtim dhe rikonstruktion;
- Mungesa e listës së detajuar të zërave të investimit(preventivit) bashkëlidhur projektit;
- Lista e detajuar e zërave të investimit(preventivi) nuk është nënshkruar nga inxhinier i licencuar;
- Në rastin e serrave, kur ofertat nuk shoqërohen me planvendosjen;
- I njëjti aplikant ka dorëzuar dy aplikime brenda një thirrje për dorëzimin e aplikimeve;

Për mangësitë e tjera përveçse sa përmendur më sipër, kërkohen dokumenta shtesë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 muaj përpara datës së aplikimit.

B. **Kontroll mbi disponueshmërinë e buxhetit:** për çdo aplikim të plotësuar dhe të miratuar, kryhet kontroll për disponueshmërinë e fondeve të grantit të Investimeve. Nëse përcaktohet se ka burime të

mjaftueshme për lidhjen e kontratës së aplikuar për investimin (projektin), përpara lidhjes së kontratës, kryhet kontrolli në terren. Nëse jo, lëshohet dokument për refuzim.

- C. **Kontroll në terren përpara lidhjes së kontratës:** vetëm aplikimet të cilat përputhen me rregullat administrative dhe të pranueshmërisë kontrollohen në terren përpara lidhjes së kontratës për të verifikuar nëse informacioni i paraqitur në aplikim është i saktë. Aplikantët vizitohen nga audituesit e AZHBR-së. Ekipi i kontrollit njofton aplikantin për të planifikuar kontrollin në terren jo më vonë se 48 orë paraprakisht. Ekipi i kontrollit është i detyruar të vërtetojë identitetin dhe autorizimin e vet, duke treguar kartën e identitetit zyrtar të AZHBR-së.

Gjatë kontrollit në terren kontrollohen dokumentet dhe pasuritë. Nëse kontrollet në terren tregojnë se aplikanti apo investimi nuk i plotëson kriteret e pranueshme, aplikimi refuzohet.

- D. **Miratimi i Investimit/projektit:** bazuar në rezultatet e të gjithë kontrolleve (administrative në terren) AZHBR-ja do të lëshojë Vendim për dhënien e Grantit.

- E. **Ankimimet:** mund të bëjnë ankesa aplikantët që besojnë se janë dëmtuar nga ndonjë gabim apo parregullsi gjatë procesit të dhënies së kontratës. Ankesa dorëzohet brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit për dhënien e Grantit ose letër Refuzimi nga AZHBR-ja. Ankesa dorëzohet në formë shkresore, nënshkruar nga aplikanti në përgjigje të vendimit të arsyetuar nga AZHBR-ja. Pas rivlerësimit të situatës për të cilën është bërë ankesa, AZHBR-ja përgjigjet për ankesën brenda afatit prej 15 ditë kalendarike.

- F. **Lidhja e kontratës:** pas miratimit të planit të investimeve (projekteve), pas skadimit të afatit për dorëzimin e ankesës, nëse ka, dhe përgjigjes përfundimtare të AZHBR mbi ankesën, aplikanti ftohet nga AZHBR (duke njoftuar) për të nënshkruar kontratën e Grantit.

Informacioni në lidhje me grantet e dhëna si dhe Lista e Grant kontratave të nënshkruara publikohet në faqen e internetit të AZHBR-së [ëëë.azhbr.gov.al](http://ëëë.azhbr.gov.al)

### 3.5. Zbatimi i Investimit

- A. **Ndryshimi i kontratës së Grantit:** bazuar në kushtet e përcaktuara në përputhje me nenin përkatës të kontratës së Grantit të nënshkruar, përfituesi kërkon ndryshimin e kontratë grantit (duke përdorur formularin që gjendet në Aneksin 5 të këtij Udhëzuesi). Kontratë Granti përcakton se kërkesa për ndryshim paraqitet në AZHBR jo më vonë se 30 ditë pune para afatit të fundit për realizimin e investimit (projektit). AZHBR-ja rivlerëson shkaqet për ndryshimin e kërkuar dhe kryen kontrolle për t'u siguruar se ndryshimi nuk ndikon në kriteret e pranueshme të grantit të Investimit. Përfituesi njoftohet në lidhje me pranimin (Njoftim mbi ndryshimin e kontratë Grantit, nëse AZHBR-ja vlerëson se kërkesa miratohet, për të nënshkruar ndryshimet e kontratës së grantit), edhe mospranimin nëse vendoset se nuk ka arsye për miratim të ndryshimit të kërkuar. Arsyet e pranueshme për të kërkuar ndryshimin e kontratës së Grantit janë:

- Forcat madhore (fatkeqësitë natyrore të tilla si: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e tokës, si dhe të lufta, revolucioni, embargo, greva, trazira dhe krimi),
- ndërprerja e prodhimit të disa mallra të cilat janë menduar si pjesë integrale e procesit,

---

***Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë***  
***Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie***  
***Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service***



- Pamundësia e ofertuesit për të ofruar shërbimin, mallrat apo punimet,
- ndryshime që rrjedhin nga nevoja për sinkronizim me legjislacionin,
- Situata që nuk parashikohen në momentin e lidhjes së kontratës dhe,
- Futja në përdorim e teknologjive të reja, që përmirësojnë eficiencën e investimit (projektit).

### **3.6. Dorëzimi, pranimi dhe regjistrimi i kërkesë Pagesave**

Pas përfundimit të investimeve dhe pagesës së të gjitha shpenzimeve të ofertuesit, përfituesi dorëzon kërkesën për pagesë (duke përdorur llojin e modelit/templati-t që gjendet në Aneksin 6-të të këtij Udhëzuesi) dhe të gjitha dokumentet e kërkuara mbështetëse (listuar në listën e dokumenteve, pjesë e kërkesë pagesës). Të gjitha së bashku formojnë "dokumentin e kërkesë pagesës". Kërkesë pagesa nuk duhet të jetë me shkrim dore.

Dokumenti i kërkesë pagesës dorëzohet në datën e përcaktuar në kontratën e Grantit të nënshkruar (E ndryshuar, nëse ndryshon).

Kërkesë pagesa dorëzohet me postë rekomande apo dorazi (përfshirë shërbimet ndërlidhëse) drejtpërsëdrejti tek Autoriteti Kontraktues (AZHBR-ja) duke marrë vërtetim me datë të nënshkruar. Adresa për dorëzimin e dokumentit të kërkesë pagesës është si më poshtë:

**Agjencia e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor  
Rruga Muhamet Gjollesha Nr. 56  
1001 Tiranë, Shqipëri**

Data e pranimit është data e dorëzimit të dokumentit të kërkesë pagesës në AZHBR.

AZHBR-ja ruan pronësinë e të gjithë kërkesë pagesave të marra. (Përveç faturës/ave origjinale) rrjedhimisht, përfituesit nuk u jepet kopje e kërkesë pagesës së tyre.

### **3.7. Pagesat**

Të gjitha kërkesë pagesat e dorëzuara vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme:

A. **Kontroll mbi plotësimin dhe pranimin:** në përputhje me kriteret kryhet kontrolli administrativ për të gjithë kërkesë pagesat. Nëse mungon ndonjë nga dokumentet e kërkuara mbështetëse apo është i paplotësuar dhe i papranueshëm administrativisht, përfituesi njoftohet të ridorëzojë dokumentin(at)/shpjegimet/ korrektimet me shkrim brenda 15 ditëve kalendarike.

Kërkesa nuk pranohet, nëse dokumentet/shpjegimet/ korrektimet nuk dorëzohen brenda afatit. Gjithashtu, dosja kërkesës për pagesë mund të refuzohet (me vendim për refuzim të kërkesës për pagesë) në qoftë se:

- kërkesë pagesa dorëzohet pas afatit të përcaktuar në Grant kontratën/e ndryshuar;
- mungon formulari i kërkesë pagesës;

- nuk përdoret lloji standart i formularit të kërkesës pagesës;
- formulari i kërkesë pagesës është me shkrim dore;
- mungojnë dokumentat mbështetëse bashkëlidhur kërkesë pagesës (përfshirë faturat);
- përfituesi nuk dorëzon dokumentacionin e munguar/ nuk riparaqet dokumentet / shpjegimet /si edhe korrektimet e kërkuara në kohën e duhur;
- dokumentet/ shpjegimet/ korrektimet edhe pse të dorëzuara në kohën e duhur nuk plotësojnë kriteret e kërkuara nga ky Udhëzues;
- përdorimi i ndërtesës nuk është në përputhje me qëllimin;
- përfituesi nuk mundëson kontrollin në terren;
- kontrolli në terren rezulton me lëshim të një raporti negativ.

B. **Kontrolli në vend para pagesës:** kontrolli në vend për të gjitha kërkesë pagesat duhet të kryhen para pagesës. Kontrolli në terren kryhet për të verifikuar që investimi (projekti) ka përfunduar sipas kontratës së nënshkruar për Grant, që (Projekti) është vënë në funksionim, punimet kanë përfunduar dhe janë kryer pagesat për të gjithë furnizuesit.

Gjatë kontrollit në terren kontrollohen dokumentet origjinale, pronat dhe auditues/it, bëjnë foto, masin parcelat e tokës, ndërtesat, mbajnë shënime dhe mbledhin çdo provë tjetër që mbështesin përgjigjet e evidentuara në listën e kontrollit.

Përfituesit vizitohen nga audituesit e AZHBR-së. Ekipi i kontrollit njofton përfituesin paraprakisht në lidhje me kontrollin e planifikuar në terren, jo më vonë se 48 orë përpara kontrollit. Ekipi i kontrollit është i detyruar të vërtetojë identitetin dhe autorizimin e tyre, duke treguar kartën zyrtare të identitetit të AZHBR -së.

Kërkesa për pagesë refuzohet, nëse kontrolli në terren vlerëson se përfituesi apo vepra e investimit nuk i plotëson kriteret e kërkuara të pranueshmërisë.

